REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 01/17
Datë/Datum. 20-01-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.01/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim me koka kabllovike",** me nr. prokurimi: **KEKO-16/407/136**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "NPRISAMONT" - PRISHTINË**		
Datë	**20.01.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me koka kabllovike",** me nr. prokurimi: **KEKO-16-407-136",** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK),** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE "**NPRISAMONT**"", me seli në – Prishtinë, me nr.prot.01/17, i datës 04.01.2017.

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		16.01.2017		17.01.2017		20.01.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 04.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 01/17, e parashtruar nga operatori ekonomik "NPRISAMONT", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me koka kabllovike", me nr. prokurimi: KEKO 16/407/136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: **"NPRISAMONT"** – ***Prishtinë.***

Neni 69 i LPP-së
Neni 70 i LPP-së
Neni 40.9, sipas Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Gjatë vlersimit të ofertave është shkel ligji i prokurimit (LPP) Neni 69 dhe 70 pasi që njëri nga dokumentet bazë të kërkuara ka qenë edhe Garancioni për produktet e ofruara për periudhën jo më te shkurte se 12 muaj. Kjo deklarat i mungon OE të cilin AK-ja e ka shpall fitues.

AK-ja arsyetohet se OE fitues në kuadër të një deklarate për specifikime teknike të detyrueshme (një deklarat e tillë as që kërkohet në DT pasi që veç egziston Aneksi 1, I specifikimeve teknike) ku thuhet se ne do ti ofrojme të gjitha produketet sipas specifikimeve teknike Aneksi 1 dhe krejt pas nenshkrimit dhe vulosjes fare në fund të faqes egziston një tekst i shtypur në formë elektronike se "Garancioni i produkteve do të jet konform FDT. Ne nuk e dim se cilit document I referoheni si FDT, mirëpo në periudhen sa patëm çasje në dokumente ne i bëm pyetje të drejpërdrejt bartësit të lëndes së AK-ja dhe ajo na dha këtë sçarim (Fleta e Dorezuar e tenderit). Pas kësaj në I kemi shfletuar te gjitha faqet/fletat dhe nuk e kemi has askund kete FDT te bashkangjitur në dosje te tenderit te OE, d.m.th mungon edhe kjo faqe'flet, pra nuk është dorëzuar. Bëhet fjal për faqen nr.4 te DT me mbishkrim PJESA A.

INFORMACIONE PËR TENDERUESIT Në këtë faqe/fletë janë kushtet të cilat duhet plotësuar secili

OE I cili don te mar pjes në këtë aktivitet të prokurimit. Ne mendojm se edhe po te dorëzohej kjo faqe/flet, kjo nuk do të nënkuptonte se është dorëzuar deklarata e kërkuar, pasi që kjo është fletë vetëm informuese për tenderuesit. Apo sipas arsyetimeve te AK, ne rastet tjera ne nuk kemi nevojë ti dorëzoi me të githa dokumentet e kërkuara ne DT, mirëpo do te mjaftonte po qe se ne e shkruajm diku një tekst ne cilin do dokumente se ne i plotësoi me të giitha kërkesat e këruara në FDT!

2. Pasi që dy oferta kan pas çmim të njëjtë, AK-ja e ka shkel Nenin 40.9 Sipas Rregullave dhe

Udhëzuesit Operativ Per Prokurim Publik, duke e perzgjedhur fituesin me votim të anëtarve të komisionit. Te paktën në Letren Standard për tenderues të pasuksesshem e cila na është dërguar ne mail kjo mund të vërtetohet.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....18.11.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-..... Furnizim/procedur e hapur
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): .....koutim i çmimit
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 01.12.2016
Data e hapjes së ofertave (N.58):.....01.12.2016-ora 12;30h
Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit-shitje/ri-tender.....16.12.2016
Kriter për dhënien e kontratës.....Çmimi më i ultë

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lote	Çmimi	Vëretje
1	INLINE ENGINEERING	PRISHTINË	-	3,717.00€	JO
2	NT RISAMONT	PRISHTINË	-	3,717.00€	JO
3	LISI GROUP	PRISHTINË	-	5,841.00€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit, ka marrë pjesë vetëm (3) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes NUK është rexhistruar asnjë vërejtje në lidhje me hapjen e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: - Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të LPP-se, Neni 65, siç është e cekur ne piken a deri ne i do të dorëzohen në formë të Aneksit 2. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesitper piken j deri ne q . 3. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, se Operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë ne pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Për piken 2 dhe 3 kërkohet vetëm nga Operatori ekonomik qe propozohet për dhënien e kontratës	
III.2.2 Përshtatshmëria profesionale Kërkesa: 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2. Regjistrimi i TVSH; 3. Regjistrimi i numrit fiskal; **Dëshmia e kërkuar dokumentare:** 1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e çertifikatës së biznesit); 2. Kopja e TVSH-se; 3. Kopja e numrit fiskal	
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional Kerkesat: 1. Katalogje të produkteve 2. Certifikatë ISO te prodhuesit për produktet e ofruara; Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Katalog nga prodhuesi me përshkrimet teknike detale për te gjithë artikujt që ofertoni. Në katalog (specifikim) të nënvizohen artikujt që keni ofertuar për çdo pozicion të kërkuar në këtë DT. 2. Certifikatë ISO 9001:2008 te prodhuesit për produktet e ofruara	

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80). Abedin SYLA: Kryesues, Idriz STUBLLA: Anëtar, Luljeta GUSIJA; Anëtar, Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 14.12.2016.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka konstatuar se kemi tri oferta pjesëmarrës të cilat i plotësojn kushtet e tenderit, me çmim të njejtë me të ulët kemi dy oferta , duke u bazuar në LPP dhe interpretimin ligjor të KRPP-së: AK-ja ka vepruar në analogji me nenin 34.8 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik. Komisioni vlerësimit me shumicë të votave të hapura ka votuar dhe propozon për dhënie të kontratës ofertën e OE INLINE ENGINEERING me çmim të ofertës 3,717.00€.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), si dhe konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim: ***Eksperti shqyrtues sqaron:*** Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar /procedur e hapur/furnizim/koutim i çmimit, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi përgjegjshëm me çmimi më i ultë". I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës të datës 16.12.2016, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues, NP RISAMONT", me seli në Prishtinë ka parashtruar ankesë në OSHP me datë 04.01.2017, me pretendimet ankimore se janë shkelur neni: Neni 69 i LPP-së Neni 70 i LPP-së Neni 40.9, sipas Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik. **Ekspertja shqyrtues** bazuar në dokumentacioni që ka në shqyrtim në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket mungesës të deklarates për garancion 12 muaj të OE të rekomanduar për kontrat, **Eksperti shqyrtues** vlerëson se autoriteti kontraktues në FDT dhe njoftimin për kontrat-koutim të çmimit tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar deklarat- kërkesat e garantimit 12 muaj, kjo kërkes NUK është plotësuar nga ana e OE të rekomanduar për kontrat duke u bazuar në ekzaminimin e dokumentacionit në ofertën origjinale të OE të rekomanduar për kontrat, njëherit

pretendimi ankimor në lidhje me këtë është i bazuar.

Eksperti shqyrtues vlerëson se komisioni vlerësimit në këtë rast NUK ka vepruar në harmoni me nenin 59.4 gjatë vlerësimit, ekzaminimit të ofertave duke u bazuar në atë që u tha më lartë se OE i rekomanduar për kontrat NUK ka plotësuar kriterin e FDT-së në lidhje me garancionin për furnizim.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të BAZUARA ankesën OE ankues "NP RISAMONT", me seli në Prishtinë dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në RI-VLERËSIM, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).